

UDHËZIM
Nr.1959, datë 19.9.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.618, DATË 7.9.2006 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në zbatim të pikës 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 “Për përcaktimin e pagës minimale për vitin 2006”,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006, është 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 16 500 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj.
3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 24 800 (njëzet e katër mijë e tetëqind) lekë në muaj.
4. Masa e kujdestarit të personit me aftësi të kufizuar, e përcaktuar sipas pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.
5. Masa e kujdestarit, e përcaktuar sipas pikës 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 9.9.2006, është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektin nga 1.9.2006.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka